

**LIGJI NR. 04/L-216
PËR BASHKËPUNIM NDËRMJET AUTORITETEVE TË PËRFSHIRA NË MENAXHIMIN E
INTEGRUAR TË KUFIRIT**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR BASHKËPUNIM NDËRMJET AUTORITETEVE TË PËRFSHIRA NË MENAXHIMIN E
INTEGRUAR TË KUFIRIT**

**KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i bashkëpunimit ndërmjet të gjitha autoriteteve që janë të përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe zbatimi i strategjive të përbashkëta të këtyre autoriteteve, në mënyrë që detyrat e parapara për këto autoritete dhe masat individuale që kanë të bëjnë me parandalimin, zbulimin dhe hetimin e aktiviteteve të kundërligjshme penale, kontrollin, monitorimin dhe bashkëpunimin përkatës ndërkombëtar, të përmbushen në mënyrë të duhur, efikase dhe efektive.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij ligji vlejné për të gjitha autoritetet që janë të përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit, për aq sa detyrat, përgjegjësitë dhe statusi i tyre nuk është i rregulluar me dispozita tjera ligjore.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. Menaxhimi i Integruar i Kufirit (MIK) – bashkëpunimi dhe bashkërendimi kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet të gjitha autoriteteve të përfshira në sigurinë e kufirit dhe lehtësimin e tregtisë për të vendosur menaxhim kufitar efektiv, efikas dhe të bashkërenduar në mënyrë që të arrihet objektivi për kufij të hapur, por të kontrolluar dhe të sigurt.

1.1.1. MIK përbëhet prej këtyre dimensioneve:

1.1.1.1. kontrolli kufitar (kontrollimi dhe mbikëqyrja) sipas përkufizimit në kodin e kufijve të zonës Schengen, përfshirë analizat përkatëse të rrezikut dhe inteligjencën lidhur me krimet;

1.1.1.2. zbulimi dhe hetimi i krimeve ndërkufitare në bashkërendim me të gjitha autoritetet që janë të përfshira në MIK;

1.1.1.3. modeli katër qasësh i kontrollit (masat në shtetet e treta, bashkëpunimi me shtetet fqinje, kontrolli kufitar, masat e kontrollit brenda zonës së lëvizjes së lirë, përfshirë kthimin);

1.1.1.4. bashkëpunimi ndërmjet agjencive për MIK dhe bashkëpunimi ndërkombëtar;

1.1.1.5. bashkërendimi dhe koherenca e aktiviteteve të shteteve anëtare dhe të institucioneve dhe organeve të tjera të Bashkimit Evropian.

1.1.2. Bashkëpunimi kombëtar nënkupton:

1.1.2.1. bashkëpunim brenda agjencive në nivelin qendror dhe lokal, ndërmjet autoriteteve të ndryshme apo njësive brenda një ministrie;

1.1.2.2. bashkëpunim ndërmjet agjencive dhe të gjitha autoriteteve që janë të përfshira në MIK dhe kontrollin e kufirit shtetëror.

1.1.3. Bashkëpunimi ndërkombëtar përfshinë bashkëpunimin me shtetet fqinje dhe shtetet e treta, si dhe organizatat dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtar në nivele multilaterale dhe bilaterale.

1.2. Autoritetet publike që janë të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit (në tekstin e mëtejshëm: Autoritetet e përfshira në MIK) – i përfshijnë këto autoritete: Policinë e Kosovës, Doganën e Kosovës dhe Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë. Autoritetet tjera të përfshira në MIK janë të përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji;

1.3. Zyra e Koordinatorit Kombëtar për MIK – zyrë e cila është përgjegjëse për bashkërendimin dhe monitorimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të përfshira në MIK;

1.4. Bordi Ekzekutiv për MIK – autoriteti bashkërendues dhe mbikëqyrës i autoriteteve të përfshira në MIK;

1.5. Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit – qendër e themeluar sipas Ligjit për Kontrollin e Kufirit Shtetëror, me qëllim të arritjes së bashkërendimit efektiv, mundësisht të shkëmbimit të informatave, të dhënave dhe efikasitetit më të madh të sistemit për MIK;

1.6. Analiza e rrezikut – përdorimi sistematik i informatave të disponueshme për të përcaktuar se sa shpesh mund të paraqiten rreziqet dhe se cilat janë përmasat dhe pasojat e tij;

1.7. Vlerësimi i rrezikut – caktimi sistematik i prioriteteve të menaxhimit të rrezikut, përmes vlerësimit dhe krahasimit të niveleve të rreziqeve pas përcaktimit të standardeve, caktimit të nivelit të rreziqeve dhe kriterëve të tjera;

1.8. Profili i rrezikut – është kombinim i përcaktuar i treguesve të rrezikut, bazuar në informatat e mbledhura, të analizuar dhe të kategorizuara;

1.9. Menaxhimi i rrezikut – identifikimi sistematik i rrezikut dhe zbatimin e të gjitha masave për të kufizuar ekspozimin ndaj rrezikut. Këtu përfshihen aktivitetet si: mbledhja e të dhënave dhe informatave, analiza dhe vlerësimi i rrezikut, përcaktimi, ndërmarrja dhe mbikëqyrja e rregullt e veprimeve dhe shqyrtimi i procesit bazuar në burimet dhe Strategjinë Ndërkombëtare;

1.10. Kufiri shtetëror – është vija që e ndanë territorin tokësor, ujor, nëntokësor, hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës me shtetet fqinje, si dhe kufiri shtetëror në zonën e pikave të kalimit kufitar në aeroporte, nëpërmjet të cilave zhvillohet komunikacioni ndërshtetëror dhe ndërkombëtar, siç është e përcaktuar në Ligjin për Kontrollin e Kufirit Shtetëror;

1.11. Pikat e kalimit kufitar - janë vendet e caktuara prej organeve kompetente të pushtetit shtetëror për kalimin e kufirit shtetëror në komunikacionin rrugor, hekurudhor dhe ajror siç është e përcaktuar në Ligjin për Kontrollin e Kufirit Shtetëror;

1.12. **Kontrolli kufitar** – aktivitet i kryer në kufi në pajtim dhe për qëllimet e këtij ligji, dhe vetëm në përgjigje të një tentimi të kalimit apo aktit të kalimit të atij kufiri, pavarësisht tjetër konsiderate, e përbërë nga kontrollimi kufitar dhe mbikëqyrja kufitare, siç është e përcaktuar në Ligjin për Kontrollin e Kufirit Shtetëror;

1.13. **Mbikëqyrja kufitare** – mbikëqyrja e kufirit shtetëror ndërmjet pikave të kalimit kufitar dhe mbikëqyrja e pikave të kalimit kufitar jashtë orarit të caktuar të punës, me qëllim që të pengohet anashkalimi, përkatësisht shmangia e kontrollimit kufitar, siç është e përcaktuar në Ligjin për Kontrollin e Kufirit Shtetëror;

1.14. **Kontrollimi kufitar** – kontrollimi që kryhet në pikat e kalimit kufitar për të siguruar që personat, mallrat dhe mjetet e tyre të transportit janë të autorizuar të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës apo ta lëshojnë Republikën e Kosovës siç është e përcaktuar në Ligjin për Kontrollin e Kufirit Shtetëror.

Neni 4

Parimet udhëheqëse gjatë kryerjes së veprimeve për MIK

1. Gjatë kryerjes së veprimeve të MIK-ut, autoritetet e përfshira në MIK duhet t'i bazojnë ato veprime në parimet e paraqitura në vijim:

1.1. **Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë** – veprimet që ndërmerren për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit dhe akteve të kundërligjshme në kufi, ndërkufitare dhe më gjerë, duhet të bazohen në dispozitat e parapara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjisllacionin në fuqi, marrëveshjet ndërkombëtare dhe standardet e BE-së.

1.2. **Parimi i lirive dhe të drejtave të njeriut** - ky parim siguron garantimin e lirive dhe të drejtave të të gjithë individëve, gjatë të gjitha fazave të angazhimit institucional në parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit dhe akteve të kundërligjshme në kufi, ndërkufitare dhe më gjerë.

1.3. **Parimi i sigurisë** - ky parim nënkupton garantimin e të drejtës për siguri dhe mbrojtje për të gjithë qytetarët nëpërmjet parandalimit dhe zvogëlimit të të gjitha formave të krimit dhe akteve të kundërligjshme në kufi, ndërkufitare dhe më gjerë.

1.4. **Parimi i prioritetit** – parandalimi dhe luftimi i krimit dhe akteve të kundërligjshme në kufi, ndërkufitare dhe më gjerë, është prioritet për institucionet dhe agjencitë e Republikës së Kosovës. Përkushtimi i përgjithshëm për t'i trajtuar këto probleme në mënyrë serioze është element qenësor.

1.5. **Parimi i profesionalizmit** – parandalimi dhe luftimi i krimit dhe akteve të kundërligjshme në kufi, ndërkufitare dhe më gjerë, kërkon ekspertë të mirë, shkëmbim të përvojave, mjete të përshtatshme, praktika të mira. Kjo nënkupton një kombinim të trajnimit, edukimit dhe zhvillimit profesional për institucionet dhe agjencitë e Republikës së Kosovës si dhe përkujdesjen për të punësuar vetëm specialistët e cilësisë më të mirë.

1.6. **Parimi i vazhdimësisë** – të gjitha veprimet e parapara duhet të shihen si pjesë e një strategjie të vazhdueshme. Kjo është posaçërisht e rëndësishme për shkak të pranisë së kufizimeve kohore administrative, procedurale si dhe për shkak të iniciativave, veprimeve të ndryshme, është e nevojshme të ndërliiden veprime të cilat do t'iu qëndrojnë shumë viteve.

1.7. **Parimi i besueshmërisë** - institucionet dhe agjencitë përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e krimit dhe akteve të kundërligjshme, duhet të sigurojnë krijimin e besimit dhe ruajtjen e integritetit dhe parandalimin e keqpërdorimit të hetimeve, të të dhënave dhe informatave nga ata që kanë qasje në to.

1.8. **Parimi i proporcionalitetit** - nënkupton ushtrimin e autoritetit të institucioneve dhe agjencive që janë të përfshira në parandalimin dhe luftimin e krimit dhe akteve të kundërligjshme, vetëm deri në atë masë që është e nevojshme për arritjen e objektivave

legjitime, me mjete dhe metoda të përshtatshme dhe në kohë sa më të shkurtër të mundshme.

KREU II AUTORITETET E PËRFSHIRA NË MIK

Neni 5

Policia e Kosovës – Policia Kufitare, Dogana e Kosovës dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.

1. Policia Kufitare, si pjesë e Policisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Policia Kufitare) është përgjegjëse për kontrollimin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin për Policinë, Ligjin për Kontrollin e Kufirit Shtetëror dhe aktet e tjera normative të Republikës së Kosovës.

2. Dogana e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm Dogana), është përgjegjëse për zbatimin e kodit doganor dhe akcizave, akteve nënligjore për zbatimin e tij dhe akteve tjera ligjore të Republikës së Kosovës. Dogana, siguron mbrojtjen e interesave të Republikës së Kosovës, që kanë të bëjnë me importet, eksportet dhe transitet e mallrave, pavarësisht nga mënyra e transportit, lidhur me dërgesat ndërkombëtare, me kalimin në pikat kufitare dhe me qarkullimin e lirë të mallrave, të personave dhe të bagazheve të tyre. Dogana kryen edhe detyra dhe përgjegjësi tjera që i caktohen Doganës nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

3. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (në tekstin e mëtejshëm: AUV) është përgjegjëse për kontrollin e sigurisë së ushqimit, përfshirë ushqimin e kafshëve, kujdesin e kafshëve dhe cilësinë e produkteve ushqimore me origjinë bimore dhe shtazore. AUV kryen edhe detyra dhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara me Ligjin për Ushqimin, Ligjin e Veterinarisë, Ligjin për Mbrojtjen e Bimëve dhe aktet tjera normative të Republikës së Kosovës.

4. Gjatë kryerjes së detyrave, autoritetet e përfshira në MIK do të bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet e tyre lidhur me Menaxhimin e Integruar të Kufirit. Bashkëpunimi sipas këtij paragrafi realizohet përmes Bordit Ekzekutiv të MIK dhe organeve tjera të themeluara nga ky Bord.

5. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, shtrihet në të gjitha nivelet organizative të Autoriteteve të përfshira në MIK, përfshirë nivelin qendror dhe lokal.

6. Autoritetet e përfshira në MIK, do t'i caktojnë zyrtarët përgjegjës për të gjitha nivelet e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të përcaktuara në paragrafin 4. të këtij neni.

7. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, autoritetet e përfshira në MIK do të bashkëpunojnë me agjencitë e huaja, përfshirë edhe autoritetet përgjegjëse për kontrollimin dhe mbikëqyrjen e kufirit në shtetet fqinje të Republikës së Kosovës, shtetet e tjera dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë të cilat në kuadër të fushëveprimit të tyre mbulojnë çështjet që kanë të bëjnë me MIK.

8. Bashkërendimi nga paragrafi 7 i këtij neni, do të zhvillohet në përputhje me Legjislacionin në fuqi që rregullon fushat dhe përgjegjësitë e autoriteteve të përfshira në MIK.

9. Në rastet e bashkëpunimit të përcaktuar në paragrafin 7 të këtij neni, autoritetet e përfshira në MIK i informojnë autoritetet tjera të përfshira në MIK rreth natyrës dhe fushës së bashkëpunimit. Autoritetet e përfshira në MIK e informojnë edhe Bordin Ekzekutiv të MIK.

Neni 6

Autoritetet tjera të përfshira në MIK

1. Përveç autoriteteve të përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji, në MIK janë të përfshira edhe këto autoritete:

1.1. Ministria e Punëve të Brendshme;

- 1.2. Ministria e Financave;
- 1.3. Ministria e Infrastrukturës;
- 1.4. Ministria e Shëndetësisë,
- 1.5. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- 1.6. Ministria e Administratës Publike;
- 1.7. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- 1.8. Ministria e Punëve të Jashtme;
- 1.9. Ministria e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës.

2. Autoritetet nga paragrafi 1 i këtij neni do të ofrojnë kryesisht shërbime mbështetëse për autoritetet e përfshira në MIK të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, por në raste specifike ato mund të jenë të përfshira në funksione primare dhe operative që kanë të bëjnë me çështjet e MIK-ut. Autoritet nga paragrafi 1 i këtij neni, do t'i kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në përputhje me Ligjin për Kontrollin e Kufirit Shtetëror dhe aktet tjera normative të Republikës së Kosovës.

3. Detyrat dhe përfshirja e autoriteteve në funksionet primare dhe operative në çështjet e MIK-ut, për raste të caktuara do të bëhet përmes kërkesës drejtuar Koordinatorit Kombëtar për MIK, adresuar autoriteteve të përfshira në MIK, dhe gjithashtu me kërkesën e autoriteteve të përfshira në MIK të adresuar tek Koordinatori Kombëtar për MIK dhe miratimin e këtij të fundit.

4. Përveç autoriteteve të përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni, ministritë dhe organet tjera të Republikës së Kosovës do të përfshihen kur është e nevojshme për të menaxhuar situata specifike dhe në rastet tjera kur konsiderohet të jetë e nevojshme nga Koordinatori Kombëtar për MIK.

KREU III BASHKËPUNIMI BRENDA AUTORITETEVE

Neni 7 Bashkëpunimi brenda autoriteteve

1. Bashkëpunimi brenda autoriteteve për secilin autoritet të përfshirë në MIK, në rast nevojë, do të zhvillohet në të gjitha nivelet, në nivelin qendror dhe lokal.
2. Bashkëpunimi i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni në rast nevojë, do të zhvillohet mes departamenteve të ndryshme dhe njësisë në kuadër të secilit autoritet të përfshirë në MIK në njësitë e ndryshme regjionale dhe njësitë e ndryshme lokale.
3. Autoritetet e përfshira në MIK, në kuadër të kompetencave të tyre do të miratojnë, rregulloret dhe udhëzimet e nevojshme, me qëllim të kryerjes së aktiviteteve të MIK-ut siç e parasheh ky ligj.

KREU IV BASHKËPUNIMI NDERMJET AGJENCIVE

Neni 8 Bashkërendimi dhe monitorimi i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të përfshira në MIK

1. Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (në tekstin e mëtejme koordinatori Kombëtar për MIK) është përgjegjëse për bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të përfshira në MIK.

2. Koordinatorin Kombëtar për MIK emërohet nga Kryeministri me propozim të Ministrit të Punëve të Brendshme.

3. Koordinatorin Kombëtar për MIK, përveç tjerash, është përgjegjës për:

3.1. identifikimin e përparësive në fushën e MIK-ut;

3.2. sigurimin e mjeteve të mjaftueshme financiare – nga Buxheti i Kosovës dhe fondet e jashtme - për zbatimin e reformave në kuadër të MIK-ut;

3.3. miratimin e dokumenteve zyrtare në lidhje me MIK-un;

3.4. monitorimin e zbatimit të Strategjisë së MIK-ut dhe Planit të Veprimit;

3.5. bashkërendimin e veprimeve të Strategjisë për MIK me vendet fqinje, si dhe monitorimin e vënies në zbatim të aktiviteteve që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e bashkërendimit dhe bashkëpunimit të MIK-ut me organet e tjera bashkërenduese të nivelit të lartë në rajon;

3.6. monitorimin e punës së Bordit Ekzekutiv të MIK-ut.

4. Në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive të tij, Koordinatorin Kombëtar për MIK mbështetet nga sekretariati për MIK, i cili është përgjegjës për të përcjellë aktivitetet e autoriteteve të përfshira në MIK dhe ta informojë Koordinatorin Kombëtar për MIK për këto aktivitete.

5. Autoriteti i përfshirë në MIK i dërgon raporte në lidhje me aktivitetet e tyre në fushën e menaxhimit të kufirit dhe zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit për MIK, sekretariatit për MIK. Periudha dhe forma e raportimit përcaktohet me vendim të veçantë të Koordinatorit Kombëtar për MIK. Sekretariati për MIK, në bazë të raporteve dhe informatave në lidhje me menaxhimin e kufirit, përpilon raporte analitike dhe i jep propozime për çështje të caktuara koordinatorit Kombëtar për MIK.

6. Koordinatorin Kombëtar për MIK aprovon procedurat standarde të veprimit me të cilat rregullohet bashkëpunimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve ndërmjet agjencive dhe autoriteteve të përfshira në MIK.

Neni 9 Bordi Ekzekutiv i MIK-ut

1. Bordi Ekzekutiv i Menaxhimit të Integruar të Kufirit (në tekstin e mëtejshëm: Bordi Ekzekutiv i MIK) funksionon me qëllim të bashkërendimit dhe bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të përfshira në MIK.

2. Bordi Ekzekutiv për MIK përbëhet nga Koordinatorin Kombëtar për MIK, Drejtori i Departamentit të Policisë Kufitare, Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës dhe Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës. Në mbledhjet e Bordit Ekzekutiv për MIK, me ftesë të koordinatorit Kombëtar për MIK, mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të organizatave ose përfaqësues të shteteve fqinje dhe shteteve tjera.

3. Mbledhjet e Bordit thirren dhe udhëhiqen nga Koordinatorin Kombëtar për MIK ose i deleguari i tij.

4. Bordi Ekzekutiv për MIK është përgjegjës dhe merr vendime për çështjet që kanë të bëjnë me:

4.1. iniciimin dhe bashkërendimin e reformave të nevojshme për të siguruar që të ekzistojnë kushtet administrative, institucionale dhe legjislative për zbatimin e MIK-ut;

4.2. zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për MIK, sipas shtyllave të MIK-ut;

4.3. dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet autoriteteve;

- 4.4. përditësimin e rregullt të Strategjisë së MIK dhe Planit të Veprimit;
 - 4.5. bashkëpunimin me të gjitha organet e administratës shtetërore dhe organet tjera lokale dhe rajonale ndërkombëtare për çështje që lidhen me MIK;
 - 4.6. ofrimin e ndihmës për organet e administratës shtetërore në çështjet e MIK, duke përfshirë bashkërendimin e veprimtarive apo projekteve të veçanta;
 - 4.7. rishikimin e Strategjisë për MIK dhe Planit të Veprimit;
 - 4.8. krijimin dhe bashkërendimin e nën-grupeve të punës për zbatimin e Planit të Veprimit;
 - 4.9. ofrimin e sugjerimeve për zgjidhjen e çështjeve të kontestuara midis autoriteteve të përfshira në MIK dhe personave juridik të përfshirë në trafikun kufitar.
5. Bordi ekzekutiv për MIK gjatë punës së tij mbështetet nga sekretariati për MIK siç është përcaktuar në nenin 8 paragrafi 4 dhe 5 të këtij ligji. Sekretariati për MIK ofron mbështetje teknike dhe përpilon raporte për zbatimin e politikave të MIK.

Neni 10

Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar

1. Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar ka për qëllim arritjen e bashkërendimit efektiv, lehtësimin të shkëmbimit të informacionit dhe të dhënave dhe një efikasitet më të madh të sistemit për MIK, në bazë të Ligjit për Kontrollin e Kufirit Shtetëror.
2. Qendra do të vendoset në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe do të ketë në përbërjen e saj, zyrtarë të Policisë Kufitare, të Doganës së Kosovës, Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, si dhe përfaqësues të autoriteteve tjera të Republikës së Kosovës kur kjo është e nevojshme.
3. Zyrtarët e Policisë Kufitare, të Doganës së Kosovës dhe Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, do të jenë prezent në qendër 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Përfaqësuesit e autoriteteve tjera do të jenë prezent në qendër në bazë të nevojës dhe mund të jenë prezent edhe në baza të rregullta (orar të rregullt) në bazë të pëlqimit paraprak të Bordit Ekzekutiv për MIK.
4. Ne kuadër të qendrës, përveç tjerash funksionon edhe njësi për inteligjencë dhe analizë të përbashkët të rrezikut.
5. Detyrat dhe përgjegjësitë e Qendrës rregullohen me akt të veçantë nënligjor të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës siç është e përcaktuar me Ligjin për Kontrollin e Kufirit Shtetëror si dhe Procedurat Standarde të Veprimit të miratuara nga Koordinatorin Nacional për MIK.

Neni 11

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve të përfshira në MIK në nivelin lokal

1. Me qëllim të bashkëpunimit dhe bashkërendimit sa më efikas të autoriteteve, autoritetet e përfshira në MIK, me theks të veçantë, Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë do të themelojnë mekanizmat për bashkëpunim në nivelin lokal.
2. Bashkëpunimi nga paragrafi 1 i këtij neni, do të realizohet përmes takimeve të rregullta ndërmjet zyrtarëve të lartë të autoriteteve të përfshira në MIK, përgjegjës për Pikat e Kalimit Kufitar.
3. Përveç zyrtarëve nga paragrafi 2 i këtij neni, në takimet e rregullta do të marrin pjesë edhe zyrtarët tjerë përgjegjës për fusha specifike në pikat e kalimit kufitar, duke përfshirë udhëheqësit e ndërrimit, zyrtarët për analizë të rrezikut dhe zyrtarët tjerë në varësi të nevojave të përditshme.
4. Takimet nga paragrafi 1 i këtij neni njëkohësisht do të funksionojnë edhe si borde lokale për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në MIK dhe do të marrin vendimet që ndërlidhen me funksionimin sa më efikas dhe efektiv të pikës së kalimit kufitar.

5. Përveç tjerash, bashkëpunimi nga paragrafi 1 i këtij neni do të përqendrohet në:

5.1. shkëmbimin e informatave operative që ndërliken me çështjet e sigurisë së kufirit;

5.2. planifikimin e operacioneve dhe kontrollimeve të përbashkëta;

5.3. identifikimin e nevojave të përbashkëta për pajisje, trajnime përmirësime në infrastrukturë, etj;

5.4. çështjeve tjera që kanë të bëjnë me përmirësimin dhe lehtësimin e kontrollimit kufitar kur kjo është e nevojshme.

Neni 12

Marrëveshjet ndërmjet autoriteteve

1. Marrëveshjet ndërmjet autoriteteve nënshkruhen nga përfaqësuesit e dy ose më shumë autoriteteve të përfshira në MIK në çdo nivel, duke përcaktuar në hollësi mënyrat e bashkëpunimit. Marrëveshjet ndërmjet autoriteteve, në veçanti u referohen fushave në vijim, por duke mos u kufizuar vetëm në to:

1.1. obligimet për shkëmbimin e informatave dhe të dhënave, mbledhja dhe përpunimi i të dhënave, shfrytëzimi sipas përcaktimit të databazave të ndryshme, qasja në shkëmbimin e të dhënave dhe procedurat për bartjen e të dhënave;

1.2. analiza e përbashkët e rrezikut,

1.3. shkëmbimi i raporteve të analizës së rrezikut dhe të inteligjencës në çdo nivel si dhe harmonizimin e sistemeve për analizën e rrezikut;

1.4. procedurat e bashkëpunimit ditor në pikë kalimet kufitare, përgjatë vijës kufitare dhe në brendësi;

1.5. aktivitete trajnuese të përbashkëta;

1.6. shfrytëzimi dhe përdorimi i përbashkët i pajisjeve;

1.7. inteligjenca kriminale dhe hetimet e përbashkëta.

2. Marrëveshjet ndërmjet autoriteteve nga paragrafi 1. i këtij neni, kur kërkohet, do të plotësohen me udhëzime të sakta për stafin e autoriteteve të përfshira në MIK për zbatimin e tyre.

KREU V

BASHKËRENDIMI DHE BASHKËPUNIMI NË MES TË AUTORITETEVE TË PËRFSHIRA NË MIK NË FUSHAT ME INTERES TË VEÇANTË

Neni 13

Bashkëpunimi në luftimin e krimit ndërkufitar

1. Autoriteti i përfshirë në MIK, në bazë të kërkesës, mund të zbatojë një masë lidhur me luftimin e krimit në emër të një autoriteti tjetër dhe në fushën e përgjegjësisë së autoritetit në fjalë, duke zbatuar kompetencat që zbatohen gjatë detyrave të veta për luftimin e krimit nga fusha e përgjegjësisë së vet.

2. Autoriteti i përfshirë në MIK nga paragrafi 1 i këtij neni mund të zbatojë një masë urgjente lidhur me një detyrë në luftimin e krimit të referuar në paragrafin 1 të këtij neni, duke zbatuar kompetencat të cilave u referohet paragrafi 1 i këtij neni, edhe pa ndonjë kërkesë, nëse një masë e tillë nuk mund të shtyhet. Autoriteti në fushën e përgjegjësisë së të cilit do të zbatohet masa e përmendur, do të informohet mbi masën e ndërmarrë pa vonesë. Masa e tillë e ndërmarrë tërhiqet nëse autoriteti në emër të cilit zbatohet masa, e kërkon këtë ose merr përsipër detyrën.

3. Nëse Autoriteti i përfshirë në MIK, nga paragrafi 1 i këtij neni nuk e ndërmerr masën të cilës i referohet paragrafi 2 i këtij neni, ai pa vonesë, e njofton autoritetin në fushën e përgjegjësisë të të cilit bie çështja për të cilën është vënë në dijeni, nëse njoftimi i tillë është i rëndësishëm për të parandaluar një aktivitet kriminal ose për të iniciuar një hetim për këtë aktivitet kriminal ose nëse është e nevojshme për shkaqe të tjera specifike të natyrës së ngjashme.

4. Autoriteti i përfshirë në MIK, nga paragrafi 1 i këtij neni, pa vonesë do të njoftojë për atë aktivitet kriminal për të cilin është vënë në dijeni dhe për masat e ndërmarra lidhur me të për autoritetin në fushën e përgjegjësisë të të cilit i takon, duke ofruar të gjitha të dhënat për aktivitetin kriminal në një dosje e cila i dorëzohet autoritetit përkatës.

5. Masat lidhur me aktivitetin kriminal nga paragrafi 4 i këtij neni lejohen në bazë të rasteve të veçanta, në mënyrë që bashkëpunimi nga këndvështrimi i përgjegjësisë penale, të mund të japë një rezultat sa më të përshtatshëm dhe të zbatohet në atë mënyrë që të merr parasysh detyrat kryesore dhe gatishmërinë operationale të secilit autoritet. Dispozitat për vendimmarrjen sigurohen përmes aktit nënligjor të lëshuar nga Qeveria e Kosovës.

Neni 14

Shkëmbimi i të dhënave dhe informacionit ndërmjet autoriteteve të përfshira në MIK

1. Autoritetet të përfshira në MIK, në kryerjen e punëve të tyre si dhe në aktivitetet e përbashkëta, do të shkëmbejnë të dhëna dhe informata për të cilat mbahen shënime zyrtare.

2. Shkëmbimi i të dhënave dhe informatave mund të kryhet edhe përmes lidhjes së sistemeve informative, qasjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë në bazat e të dhënave.

3. Autoritetet e përfshira në MIK duhet të sigurojnë mbrojtje efektive të të dhënave, informatave të shkëmbyera, sidomos për të dhënat personale, me qëllim të parandalimit të qasjes së paautorizuar, ndryshimit apo publikimit të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dispozitat dhe rregullat e veçanta që rregullojnë sferën e mbrojtjes së të dhënave. Mbrojtja e të dhënave personale bëhet në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjin për Kontrollin e Kufirit Shtetëror.

4. Koordinatori Kombëtar për MIK do të miratoj procedurën standarde të veprimit për shkëmbimin e të dhënave dhe informatave në bazë të paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 15

Analiza e përbashkët e rrezikut dhe kërcënimeve

1. Autoritetet e përfshira në MIK, në një periudhë të përcaktuar, do të përgatisin një analizë të përbashkët të rrezikut dhe kërcënimeve, e cila do të jetë bazë për MIK dhe për një planifikim të mirë për kryerjen e aktiviteteve të përbashkëta.

2. Zyrtarët e autoriteteve të përfshira në MIK, përgjegjës për analiza të rreziqeve dhe kërcënimeve, siç është përcaktuar në paragrafin 4, nenin 10 të këtij ligji, do të përdorin kapacitetet e Qendrës në mënyrë që të përpilojnë raportet dhe analizat e përbashkëta të rreziqeve dhe kërcënimeve. Përveç tjerash, detyrat e këtyre zyrtarëve kanë të bëjnë me grumbullimin, vlerësimin, analizimin, krahasimin dhe harmonizimin e të dhënave dhe informatave ndërmjet të gjitha autoriteteve të përfshira në MIK.

3. Analiza e rrezikut dhe kërcënimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, bëhet në bazë të treguesve analitik dhe statistikor për një periudhë të caktuar si dhe të dhënave dhe informatave nga paragrafi 2 i këtij neni, për qëllim të kontrollit të kufirit, sigurinë e kufirit, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, parandalimin dhe zbulimin e krimeve dhe shkeljeve, masave të ndërmarra dhe rezultatet e arritura në zbatimin e tyre.

4. Koordinatori Kombëtar për MIK do të miratoj procedurën standarde të veprimit për analizën e përbashkët të rrezikut dhe kërcënimeve në bazë të paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 16

Veprimet dhe aksionet e përbashkëta

Autoritetet e përfshira në MIK, bazuar në analizën e rrezikut dhe kërcënimeve, si dhe kërkesave operative, me qëllim të veprimit të përbashkët dhe shfrytëzimit racional të burimeve ekzistuese njerëzore dhe teknike, planifikojnë dhe kryejnë veprime dhe aksione të përbashkëta, me qëllim të parandalimit dhe zbulimit të aktiviteteve përmes të cilave rrezikohet kufiri shtetëror, mbikëqyrja doganore dhe shëndeti i njerëzve, bimëve dhe kafshëve.

Neni 17

Ekipet e përbashkëta për inteligjencë dhe hetime

1. Autoritetet të përfshira në MIK, mund të themelojnë ekipe të përbashkëta për inteligjencë dhe hetime, me qëllim të parandalimit, zbulimit dhe hetimit të aktiviteteve kriminale. Ekipe të përbashkëta për inteligjencë dhe hetime mund të themelohen nga autoritetet të cilat janë në tërësi apo pjesërisht përgjegjëse për trajtimin e veprave penale në fjalë.

2. Vendimi për themelimit dhe pjesëmarrje në ekipin e përbashkët për inteligjencë dhe hetime merren nga vet autoritetet që marrin pjesë në punën e këtij ekipi. Vendimi për caktimin e udhëheqësit të ekipit, dhe veprat për të cilat do të mbledhet inteligjenca dhe veprat që do të hetohen nga ky ekip do të merret gjatë themelimit të këtij ekipi.

3. Në ekipin e përbashkët për inteligjencë dhe hetime, përfaqësuesi i një autoriteti gëzon të drejtën e pjesëmarrjes në zbatimin e masave të inteligjencës dhe hetimeve për të cilat ai është i autorizuar t'i kryej në fushën e tij të përgjegjësisë në kuadër të detyrave të luftimit të aktiviteteve të kundërligjshme që janë në përgjegjësinë e autoritetit në fjalë të cilat janë të nevojshme në kuadër të mbledhjes së inteligjencës apo të parandalimit, zbulimit dhe hetimit të aktiviteteve në fjalë për të cilat merret vendim nga udhëheqësi i ekipit në bazë të kompetencave të tij. Përfaqësuesi i autoritetit merr pjesë duke zbatuar masat nën komandën dhe mbikëqyrjen e nevojshme të udhëheqësit të ekipit.

Neni 18

Ndihma teknike dhe profesionale

1. Me qëllim të ngritjes së efikasitetit, operacionalizimit dhe racionalizimit të kryerjes së detyrave të tyre dhe aktiviteteve me interes të përbashkët, si dhe veprimeve të përbashkëta në fusha tjera të bashkëpunimit, autoritetet e përfshira në MIK, në mënyrë të ndërsjellë ofrojnë ekspertizë të veçantë dhe asistencë teknike.

2. Përveç nëse nuk është paraparë ndryshe me këtë ligj dhe legjislacionin tjetër në fuqi, autoriteti i përfshirë në MIK është i obliguar që përkohësisht të vë në dispozicion të një autoriteti tjetër pajisjet, objektet, burimet njerëzore apo shërbimet speciale të ekspertizës të cilat i ka në posedim por që nuk janë në dispozicion të autoritetit tjetër për përdorim të nevojshëm gjatë bashkëpunimit në luftë kundër krimit, kontrollit dhe monitorimit apo bashkëpunimit ndërkombëtar. Ndihma mund të ofrohet vetëm nëse nuk rrezikon kryerjen e detyrave të parapara nga autoriteti që ofron ndihmën.

3. Agjencitë dhe autoritetet e tjera të përfshira në MIK mund të sigurojnë pajisje teknike për përdorim të përbashkët.

Neni 19

Edukimi dhe trajnimi

1. Autoritetet e përfshira në MIK, me qëllim të ngritjes profesionale të personelit të tyre dhe shkëmbimit të përvojave organizojnë trajnime të përbashkëta në fushat me interes për MIK.

2. Në trajnimet nga paragrafi 1 i këtij neni, mund marrin pjesë edhe zyrtarë të agjencive dhe organeve tjera si dhe zyrtarë të agjencive dhe organeve të shteteve fqinje të Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera.

3. Koordinatori Kombëtar për MIK informohet për trajnimet siç është përcaktuar në këtë nen.

KREU VI BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 20

Bashkërendimi dhe bashkëpunimi me autoritetet e shteteve fqinje të Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera

1. Autoritetet e përfshira në MIK gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive të tyre që ndërlidhen me MIK, bashkëpunojnë edhe me agjencitë dhe autoritetet tjera të huaja, të cilat në fushëveprimin e tyre kanë detyra dhe përgjegjësi që ndërlidhen me MIK.
2. Përveç tjerash, bashkëpunimi nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet me qëllim të:
 - 2.1. mundësimin të qarkullimit më të shpejtë të personave, mallrave dhe mjeteve transportuese në pikat e kalimit kufitar;
 - 2.2. pengimit dhe zbulimit të krimit ndërkufitar;
 - 2.3. mbledhjes, analizës dhe shkëmbimit të dhënave dhe informatave lidhur me MIK;
 - 2.4. shkëmbimit të përvojave dhe trajnimeve;
 - 2.5. bashkërendimit të aktiviteteve dhe veprimeve.
3. Gjatë realizimit të bashkëpunimit nga ky nen, autoritetet e përfshira në MIK, mund të dërgojnë zyrtarë të tyre në vendet përkatëse dhe mund të pranojnë zyrtarë të huaj pranë agjencive të tyre, si dhe mund të ndërmarrin operacione të përbashkëta me zyrtarët e huaj përkatës.
4. Bashkëpunimi nga ky nen realizohet me marrëveshje bilaterale ose multilaterale dhe për arritjen e këtyre marrëveshjeve dhe formave të bashkëpunimit, autoritetet e përfshira në MIK duhet ta njoftojnë koordinatorin Kombëtar për MIK.
5. Bashkëpunimin nga ky nen autoritetet e përfshira në MIK mund ta bëjnë me marrëveshje të përbashkët ose me marrëveshje të veçanta.
6. Forma, mënyra dhe fushat e bashkëpunimit në territorin e Republikës së Kosovës, përmes marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale me shtetet fqinje, në nivel lokal, rregullohet me akt nënligjor.

Neni 21

Bashkërendimi dhe bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare

1. Autoritetet e përfshira në MIK gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive të tyre që ndërlidhen me MIK-un gjithashtu bashkëpunojnë me organizatat ndërkombëtare.
2. Autoritetet e përfshira në MIK duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet me qëllim të anëtarësimit në organizatat përkatëse ndërkombëtare.
3. Autoritetet e përfshira në MIK duhet ta njoftojnë Koordinatorin Kombëtar për anëtarësimin dhe kushtet e anëtarësimit nga paragrafi 2 i këtij neni.

KREU VII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 22
Strategjia Kombëtare për MIK

1. Pa paragjykuar dispozitat e këtij ligji, autoritetet e përfshira në MIK bashkëpunimin konkret ndërmjet tyre e realizojnë përmes Strategjisë Kombëtare për MIK.
2. Strategjia Kombëtare për MIK do të hartohet për një periudhë të caktuar kohore dhe hartimi i saj do të bashkërendohet nga Koordinatori Kombëtar për MIK.
3. Strategjia Kombëtare për MIK pas hartimit do të miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 23
Aktet përkatëse nënligjore

Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas nevojës nxjerr aktet përkatëse nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-216
31 korrik 2013

Shpallur me dekretin Nr. DL-040-2013, datë 19.08.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga